


- 1) Përzgjidh alternativën, e cila i ka të renditura në mënyrë kronologjike lëvizjet artistike:
- A) Neoklasicizëm; Impresionizëm; Ekspresionizëm; Pop Art;
 B) Pop Art; Ekspresionizëm; Impresionizëm; Neoklasicizëm;
 C) Impresionizëm; Ekspresionizëm; Neoklasicizëm; Pop Art;
 D) Impresionizëm; Pop Art; Ekspresionizëm; Neoklasicizëm;
- 2) Plotësoni saktë pamjen e tretë në paraqitjen me projeksione të trupit gjeometrik.



1



2



3



4

A) 3

B) 2

C) 4

D) 1

- 3) Gjeni si mund të vazhdojë sekuenca e mëposhtme:

1 — 2 — 5 — 14 — 41 — ...

A) 123

B) 121

C) 124

D) 122

- 4) Identifiko fjalën për t'u eliminuar si jokohereente me të tjerat:

A) Djathë

B) Dhallë

C) Kos

D) Vaj

- 5) Në fletët e vizatimit teknik të një objekti apo detaji vendoset si rregull shkalla e vizatimit. Kur ajo është shënuar 1:1, tregon:

A) Shkallë kopjimi

B) Shkallë zvogëlimi

C) Shkallë natyrale

D) Shkallë zmadhimi

- 6) Cilat nga veprat e mëposhtme nuk është vepër e Michelangelo Buonarroti-t?

A) "Shkolla e Athinës"

B) "Davidi"

C) "Mëshira"

D) "Kapela Sistine"

- 7) Evidento cili nga qiellgërvishtësit e renditur më poshtë nuk ndodhet në New York.

A) "One World Trade"

B) "Burj Khalifa"

C) "Rockfeller"

D) "Empire State"

8) Përzgjidhni alternativën, e cila përshkruan më mirë funksionin e objektit të ilustruar më poshtë:



- A) Banesë kolektive
- C) Sallë koncertesh

- B) Muze
- D) Pallat sporti

9) Cili nga çiftet e mëposhtme të fjalëve plotëson saktë fjalinë: 'Nuk kemi një mundësi për të bërë përshtypje ?'


- A) të dytë, të parë
- C) të vërtetë, të mirë

- B) të fundit, finale
- D) të madhe, të bukur

10) Një litër lëng me densitet 1.5 kg/l e ka masën:

- A) 1.5 kg
- B) 150 kg
- C) 1,500 kg
- D) 15 kg

11) Në figurë paraqitet rruga që nisim për t'i brëndashkruar rrethit:



- A) Katërkëndorin
- B) Gjashtëkëndorin
- C) Shtatëkëndorin
- D) Tetëkëndorin

12) Cilat numra zëvendësojnë pikëpyetjet?

3	6	8
4	1	9
7	8	7

A) 8 7 4

2	8	3
6	5	8
9	4	1


B) 6 7 4

1	7	4
6	9	8
?	?	?

C) 8 7 2

D) 7 8 4

13) Sa është lartësia e një këmbe shkalle në prerjen e dhënë, kur lartësia e katit është 3.15m ?






A) 17.5 cm

B) 16 cm

C) 16.5 cm

D) 18 cm

14) Cila është figura që mungon?



15) Cilat shkronja duhet të zëvendësojnë pikëpyetjen?

PA	DY	TR
KA	PE	GJA
SHT	TE	NË
DHJ	NJË	?






A) NJË

B) DY

C) SA

D) PA

16) Cila është kutia që mungon?



17) Tapeti i një dhome është i ngjyrosur në këtë mënyrë: $\frac{1}{6}$ është me ngjyrë të zezë, $\frac{1}{4}$ me ngjyrë të kuqe, $\frac{1}{3}$ me ngjyrë të verdhë, ndërsa pjesa tjetër me ngjyrë të bardhë përbën 6 metra katror. Sa është sipërfaqja e tapetit, nëse e shënojmë me X?

A) $X = 18 \text{ metra}^2$

B) $X = 12 \text{ metra}^2$

C) $X = 36 \text{ metra}^2$

D) $X = 24 \text{ metra}^2$

18) Bauhaus u themelua nga arkitekti:

A) Le Corbusier

B) Frank Lloyd Wright

C) Walter Gropius

D) Ludwig Mies van der Rohe

19) Cili nga imazhet e mëposhtme nuk ilustron vepër të arkitektit Frank O. Gehry?




A)



B)



C)



D)

20) Stadiumi Kombëtar “Air Albania” ilustruar më poshtë është projektuar nga arkitekti/arkitektët:



A) “Mario Cucinella”

C) “Massimiliano Fuksas”

B) “Stefano Boeri”

D) “Marco Casamonti” & “Archea”

21) Gjej korrespondencën mes autorit dhe vendndodhjes së objektit “Shtëpia Milà” e ilustruar më poshtë:



- A) Le Corbusier; Marsejë
- C) Oscar Niemeyer; Brazilia

- B) Antoni Gaudí; Barcelonë
- D) Frank Lloyd Wright; Çikago

22) Një ditë pyeta shokët se në cilin muaj do të vinte shfaqja e cirkut në qytet; ja si m’u përgjigjën secili prej tyre.

Beni: Ky muaj ka 30 ditë.

Eda : Ky muaj ka 31 ditë.

Klea: Ky muaj mbaron me shkronjën R.

Aldo: Ky muaj ka 6 gërma.

Tomi: Emri i këtij muaji, nuk ka lidhje me numrat.


Nëse vetëm njëri prej tyre po gënjen: Cili është muaji në të cilin vjen cirku e që po flasin shokët?

- A) Nëntor
- B) Shtator
- C) Qershor
- D) Janar

23) Cili është autori i romanit "Zonja Bovari"?



- A) Franz Kafka
- B) Gustav Flober
- C) Lev Tolstoy
- D) Gabriel García Márquez

24) Cili prej trupave në aksonometri korrespondon në paraqitjen me dy projeksione në V dhe H ?




- A) 1
- B) 2
- C) 4
- D) 3


25) Cila nga paraqitjet është projeksioni i saktë në horizontal i trupit të prerë me dy plane?



1



2



3



4


A) 1

B) 2

C) 3

D) 4

26) Sa është kuota horizontale në sheshpushim në planimetrinë e dhënë të shkallëve ?





A) +4.68m

B) -1.80m


C) +5.04m

D) +1.44m


27) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione për figurën gjeometrike të dhënë në aksonometri ?




1



2



3



4

A) 4

B) 1

C) 3

D) 2

28) Për të transportuar 13 kuti nga dyqani për në shtëpi, Luizi përdor biçikletën. Duke ditur që në një rrugë ai mund të mbajë vetëm 2 kuti, sa herë e përshkon rrugën nga dyqani në shtëpi e mbrapsht në mënyrë që të marrë gjithë kutitë?

A) 6

B) 14

C) 13

D) 7

29) Cili nga romanet e mëposhtme nuk është shkruar nga Ismail Kadare?

A) Kronikë në gur

B) 100 vjet vetmi

C) Prilli i thyer

D) Pallati i ëndrrave

30) Piktura e treguar në figurën e mëposhtme, vepër e artistit Gustav Klimt titullohet:




A) "Puthja"

C) "Burri dhe gruaja"

B) "Pranvera"

D) "Përçafimi"

- 31) Për të skicuar me dorë të lirë këndin e ngushtë mbi një vijë horizontale fillojmë nga një pikë **0**, duke vendosur segmentin njësi disa herë deri tek pika **a**. Më tej, tek pika **a** ndërtojmë një vijë vertikale duke vendosur segmentin njësi disa herë deri tek pika **b**. Bashkojmë **0** me **b**. Këndi perballë brinjës **ab** është këndi i ngushtë i kërkuar. Për të ndërtuar këndin 30° , sa segmente njësi duhen vendosur në vijën horizontale dhe sa në vijën vertikale?



- A) 5 njësi dhe 2 njësi
 B) 5 njësi dhe 3 njësi
 C) 5 njësi dhe 1 njësi
 D) 5 njësi dhe 5 njësi
- 32) Ani i thotë Gimit: “Nëse më jep një fletore, do të kem dyfishin e të tuave.” Gimi përgjigjet: “Nëse më jep ti një, do të kemi të njëjtin numër fletoresh.” Sa fletore kanë respektivisht Ani dhe Gimi?
 A) 3 dhe 2
 B) 4 dhe 7
 C) 9 dhe 7
 D) 7 dhe 5
- 33) Shtatë kuti kursimi përmbajnë monedha. Nëse: në çdo kuti duhet të ketë të paktën 1 (një) monedhë; në jo më shumë se tre kuti ka të njëjtin numër monedhash, ndërsa në të tjerat numri i monedhave duhet të jetë i ndryshëm. Gjeni cili është numri minimal i monedhave që gjenden në kuti?
 A) 17
 B) 28
 C) 7
 D) 13
- 34) Kush është përfaqësuesi kryesor i Pop Art-it, njëkohësisht dhe autori i veprës së mëposhtme?



- A) Robert Rauschenberg
 B) Roy Lichtenstein
 C) Keith Haring
 D) Andy Warhol

35) Nga veprat e mëposhtme, përzgjidh atë që nuk i përket piktorit Vincent van Gogh.



A)



B)



C)



D)

36) Në shkallën 3:1, në cilën përmasë do vizatohej segmenti 6 cm?

A) 0.5 m

B) 2 cm

C) 18 cm

D) 9 cm

37) Cili prej shteteve të mëposhtme nuk ka dalje në det?

A) Rumania

B) Hollanda

C) Sllovakia

D) Bullgaria

38) Vepra e mëposhtme i përket artistit:




- A) Kel Marubi
 B) Edward Lear
 C) Abdurrahim Buza
 D) Odhise Paskali

39) 40% e studentëve të një shkolle janë vajza. Nga këto, 80% janë brune. Duke ditur që vajza jo brune janë 160, sa studentë ka shkolla gjithsej?

- A) 200
 B) 400
 C) 5000
 D) 2000

40) Sa trekëndësha mund të numëroni në figurë?




- A) 21
 B) 27
 C) 24
 D) 22

41) Një trup nisët nga prehja me nxitim 10cm/s^2 . Pas 10 sekondash, shpejtësia e tij është:


- A) 1 m/s
 B) 10 cm/s
 C) 100 m/s
 D) 10 m/s

42) Sa është sipërfaqja në m^2 e dhomës së paraqitur në plan referuar përmasimit të krevatit në cm ?



- A) 16.2 m^2
 B) 14.4 m^2
 C) 12 m^2
 D) 8.1 m^2

43) Lidhni paraqitjen me projeksione me paraqitjen aksonometrike përkatëse të trupit gjeometrik.



A) 3B, 4A, 5E, 6F, 1C, 2D
C) 2C, 3F, 4D, 5E, 6A, 1B

B) 4C, 5E, 6F, 1D, 2B, 3A
D) 5C, 6E, 3D, 4B, 1F, 2A

44) Pallati Dukal në Venecia, i ilustruar më poshtë, është i stilit:






A) Romanik B) Të rilindjes C) Gotik D) Barok

45) Cila nga fjalët e mëposhtme duhet vendosur në vend të pikëpyetjes?

Ajër	Rosa	Alarm	Balona
Rast	Ura	Lumi	Ibrik
Iriq	Lëndina	Italian	?


A) Rëndësi B) Ndërtues C) Banor D) Artist

- 46) Cili prej shoqërimeve të mëposhtme nuk është i saktë:
- A) Frederik Ndoci-këngëtar
B) Vangjush Mio-piktor
C) Xhanfize Keko-regjizore
D) Dhimitër Anagnosti-shkrimtar
- 47) Në cilën prej konferencave të mëposhtme, Këshilli Nacionalçlirimtar dhe Balli Kombëtar arritën një marrëveshje për të krijuar një front të përbashkët kundër pushtuesit gjatë Luftës së Dytë Botërore?
- A) Konferencën e Pezës
B) Konferencën e Bujanit
C) Konferencën e Mukjes
D) Konferencën e Londrës
- 48) Cila është kutia që mungon?




- 49) Në një kuti ka 10 zara të bardhë, 9 zara të zinj dhe 3 të verdhë. Nëse marrim një zar rastësisht, sa është probabiliteti që të nxjerrim nga kutia një zar të zi ose një zar të verdhë?
- A) $6 / 11$
B) $1 / 2$
C) $9 / 22$
D) $3 / 22$
- 50) Kush nga autorët e mëposhtëm nuk ka qenë pjesë e grupit të punës në realizimin e veprës “Nëna Shqipëri”?
- A) Kristaq Rama
B) Shaban Hadëri
C) Vangjush Mio
D) Mumtaz Dhrami
- 51) Nëse është e vërtetë që “bari i komshiut është gjithmonë më jeshil”, atëherë cili prej pohimeve të mëposhtme është detyrimisht i vërtetë?
- A) Nuk ekziston një komshi që të mos e ketë barin më jeshil.
B) Asnjë komshi nuk e ka barin të lartë në kopësht.
C) Komshiu përdor një pleh më të mirë.
D) Duhet të ekzistojë të paktën një komshi që e ka barin më pak jeshil se i imi.

52) Në figurë paraqitet rrafshi në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij.



53) Është dhënë trupi në aksonometri. Përcaktoni dy projeksionet që i mungojnë tek paraqitja me projeksione.



- A) V-4; W-5 B) V-1; W-3 C) V-3; W-1 D) V-2; W-6

54) Një kuti është e ndarë në katër nëndarje drejtkëndore të barabarta të vendosura në mënyrë të tillë që brinja gjatësore e një nëndarjeje është në kontakt me 3 brinjët anësore të tre nëndarjeve të tjera. Perimetri i kutive është 70 cm. Cilat janë dimensionet në centimetra të një nëndarjeje?

- A) 7 x 21 B) 4 x 12 C) 6 x 18 D) 5 x 15

- 55) Sokoli, Klaudia, Niku dhe Ada kanë nga një kafshë shtëpiake. Kafshët e tyre janë një lepur, një kanarinë, një mace dhe një peshk i kuq. Kafsha e Nikut ka katër putra; kafsha e Sokolit ka lëkurën me qime. Ada ka një zog dhe Klaudia dhe Niku kanë alergji nga macet. Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar?
- A) Sokoli ka një mace. B) Klaudia ka një peshk të kuq.
C) Ada ka një kanarinë. D) Sokoli ka një lepur.
- 56) Përmasat e formatit A2 të vizatimit janë:
- A) 421 mm x 597 mm B) 421 mm x 594 mm
C) 420 mm x 594 mm D) 420 mm x 597 mm
- 57) Kapitelet e kollonave greke janë të orderave si më poshtë:
- A) Order dorik B) Të gjithë orderat e mësipërm
C) Order jonik D) Order korintik
- 58) Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një republikë
- A) Presidenciale B) Popullore C) Parlamentare D) Rajonale
- 59) Lufta II Botërore nisi zyrtarisht me:
- A) Pushtimin e Austrisë
B) Deklarimin e luftës nga Gjermania, Francës
C) Pushtimin e Polonisë
D) Shpërthimin e bombës atomike
- 60) Asambleja e përgjithshme e OKB-së:
- A) Është bashkim i kryeministrave të shteteve anëtare
B) Është organ përfaqësues i shteteve anëtare
C) Është e zgjedhur
D) Ka zëvendësuar që prej 1996 Këshillin e Sigurimit

Answer Key

Testname: UNTITLED4

- 1) A
- 2) D
- 3) D
- 4) D
- 5) C
- 6) A
- 7) B
- 8) B
- 9) A
- 10) A
- 11) D
- 12) C
- 13) A
- 14) B
- 15) B
- 16) B
- 17) D
- 18) C
- 19) B
- 20) D
- 21) B
- 22) C
- 23) B
- 24) A
- 25) D
- 26) D
- 27) C
- 28) C
- 29) B
- 30) A
- 31) B
- 32) D
- 33) A
- 34) D
- 35) D
- 36) C
- 37) C
- 38) A
- 39) D
- 40) B
- 41) A
- 42) B
- 43) D
- 44) C
- 45) A
- 46) D
- 47) C
- 48) D
- 49) A
- 50) C
- 51) A
- 52) C
- 53) A
- 54) D

Answer Key

Testname: UNTITLED4

55) D

56) C

57) B

58) A

59) C

60) B